



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1730/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), sh.a, me nr. Biznesi 70325399 me seli ne në Prishtinë, Rr.” Nënë Tereza”, nr.36, ndaj debitorit M.Mark “Denti” N.S.R. adresa rr.”Imzot Nik Prela” Hyrja E 30 Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.439/22 datë 07.09.2023, me datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), sh.a, me seli në Prishtinë, Rr.” Nënë Tereza”, nr.36, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.439/22 i datës 07.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.439/22 dt.07.09.2023, ka Pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit M.Mark “Denti” N.S.R. me adresë rr. “Imzot Nik Prela” Hyrja E 30 Prishtinë, dhe ka Shfuqizuar urdhrin përmbarimor P.nr.2662/18 dt.19.12.2018, i lejuar nga Përmbaruesja Private Rezarta Metaj

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të se drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës se dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne shkallë te parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në përgjigjen në ankesë, debitori deklaroi se ankesa është e pabazuar sepse pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe i propozon gjykatës që ta refuzoj ankesën e kreditorit.

Dhomat e shkalles se dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së e lidhur me nenin 17 te Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), sh.a, me seli në Prishtinë, Rr.” Nënë Tereza”, nr.36, me datën 19.12.2018, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit M.Mark “Denti” N.S.R. adresa rr. “Imzot Nik Prela” Hyrja E 30 Prishtinë, në bazë të Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste si dokument i besueshëm, me numër Unik te Konsumatorit DPR Përmbarruesja Private Rezarta Metaj me seli ne Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin përmbarrimor P.nr.2662/18 dt.19.12.2018, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të borxhit për konsum te energjisë elektrike, nga data 07.05.2012 deri me dt. 20.03.2013, kreditorit ti paguaj shumen prej 2,247.39 euro, me kamatë prej 8% nga dita e kalimit te afatit për pagesë e deri ne pagesën definitive te borxhit se bashku me shpenzimet.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se propozimi për përmbarrim është përpiluar ne kundërshtim me nenin 38 te LPP dhe se nga ky propozim nuk dihet kush është debitori pasi debitori Denti ka tjetër numër te biznesit nga ai te cilin e ka përmendur kreditori e po ashtu ka pronar dhe person tjetër dhe jo N.R., po ashtu nuk dihet se për cilën periudhë kohore apo mbi çfarë baze është krijuar ky borxh, i referohet edhe nenit 38 par.2 te LPP ne lidhje me mungesën e numrit te biznesit ne propozimin për përmbarrim. Propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbarrimor ta anuloi si dhe ta detyroj kreditorin ti paguaj shpenzimet procedurale.

Ndaj prapësimin te debitorit, kreditori ka ushtruar përgjigje, me arsyetimin se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit në prapësim sepse propozimi për përmbarrim është konform me dispozitat ligjore, shton se bazuar ne UA nr.04/2015 për Procedurat e Faljes se Borxheve Publike, Kontratën për Pagesën e Borxhit dhe Deklaratën mbi Dakordimin e Borxhit dhe pasi debitori nuk ka paguar tre këste sipas nenit 3 te Kontratës për Pagesën e Borxhit, atëherë kreditori KEK i ka rikthyer vlerën e falur te borxhit, ndërsa pagesa ne emër te konsumit te energjisë për KEK - kësteve 9-12 i është minusuar ne vlerën e përgjithshme te borxhit, dhe vlera e mbetur është 2,247.39 euro, andaj propozon që urdhri përmbarrimor te mbetet ne fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.439/22 dt.07.09.2023, me të cilin ka vendosur decidivishtsi ne dispozitiv te aktvendimit. Gjykata e shkallës se parë ka vlerësuar se propozimi për përmbarrim është ne kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 38 par.1 dhe 2 i LPP, sepse nuk është përcaktuar emri i debitorit, numri i biznesit te debitorit apo te dhënat tjera për identifikimin e tij, arsyeton se vetëm përshkrimi i debitorit si M.Market N.S.R. pa treguar emrin e saktë te debitorit dhe numrin e biznesit, pasi tek numri i biznesit figuron numri personal dhe jo numri i biznesit nuk është e mjaftueshme për identifikimin e debitorit te përmbarrimit. Gjykata ne këtë rast i referohet edhe nenit 43 par.4 te LPP përkitazi me vendosjen e tij për anulimin e urdhrin përmbarrimor.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbare, Aktvendimi i atakuar rezulton të mos jetë përfshirë as me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së dhe nuk ka as shkelje lidhur me zbatimin e të drejtës materiale për të cilat Gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Po ashtu aktvendimi i atakuar nga gjykata e shkallës së parë është marrë pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të cilat kanë mbështetje në shkresat e lëndës dhe në ligj.

Ne lidhje me këtë çështje kjo gjykatë analizon propozimin për përmbare të kreditorit dhe pranon në tërësi përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, sepse është fakt se ne propozimin për përmbare kreditori nuk ka paraqitur të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e debitorit. Sipas propozimit për përmbare debitori është precizuar si M.Mark “Denti” N.S.R. ndërsa nga të dhënat nga Web faqja e ARBK, nuk rezulton ky debitor dhe se edhe nga numri personal ... i dhënë nga kreditori ne propozimin për përmbare nuk rezultojnë të dhënat e debitorit në rastin konkret, ndërsa analizuar paragrafin 2 të nenit 38 të LPP, rezulton se organi përmbare nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të korrigjimit të propozimit për përmbare në lidhje me sigurimin e të dhënave tjera të mjaftueshme për identifikim të debitorit.

Edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret Ekstrakti i lëshuar nga kreditori ashtu siç është, nuk plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm nga neni 29 pika 1.2 dhe 21 të LPP, dhe si rezultat i kësaj rrjedh se propozimi për përmbare i kreditorit është ushtruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Ne këtë aspekt gjykata e shkallës së dytë vlerëson se me nenin 43 par.4 të LPP i cili parasheh që *“Përmbareuesit privat nxjerrin urdhrin për përmbareueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbareueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbareueshmërisë së nxjerrë nga përmbareuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbareimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbareuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbare nga përmbareuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*, prandaj nga e gjithë kjo del se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë qëndron dhe është i bazuar.

Edhe kjo gjykatë ka analizuar pretendimet e kreditorit por konsideron se të njëjtat nuk janë relevante për një vendosje ndryshe nga çka vendosur gjykata e shkallës së parë, ashtu që vendosi që ti refuzoj si të pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 par.1pika (b) te LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1730/23, me datë 07.05.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha